



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:040834

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05471659

**P.nr.109/22**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal**, Gjyqtarja e vetme gjykuese Benita Berisha, me zyrtarin ligjor Besart Mustafa, në çështjen penale ndaj të akuzuarit R. K., për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 par. 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.64/22 e datës 28.02.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik me datë 08.03.2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Muharrem Prekazi, të akuzuarit R. K., si dhe të dëmtuarit N. K., në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 19.03.2024, përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

**R. K.**, nga i ati B., e ëma R., e vajzërisë R., i lindur me datë ..., në Mitrovicë, me vendbanim në rrugën "...", Mitrovicë, me numër personal të identifikimit ..., i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, punon punë fizike, i gjendjes së dobët ekonomike, ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

#### SEPSE:

Me datë 06.12.2021, rreth orës 02:06, në Mitrovicë, në rrugën "...", ka marrë pasurinë e personit tjetër me qëllim që vetës t'i sjell dobi të kundërligjshme pasurore, në atë mënyrë që në hyrjen e një ndërtese, në korridor, ka marrë një fshesë-karrocë për pastrimin e parketit dhe keramikës, e cila është në pronësi të dëmtuarit N. K., vlera e se cilës është 100 euro, dhe me të njëjtën është larguar.

-Me këtë ka kryer veprën penale: Vjedhja nga neni 313 par. 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të neneve: 1, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70 lidhur me nenin 313 par. 1 të KPRK-së, si dhe neneve:364, 365, 449, 452 dhe 460 të KPP-së, i shqipton:

## DËNIM ME KUSHT

- I. Të akuzuarit R. K., i vërteton Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, dhe Dënim me Gjobë në shumën prej dyqind (200) euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej një (1) viti nuk kryen veprë tjetër penale, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumën prej tridhjetë (30) euro, në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.
- III. Pala e dëmtuar N. K., ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike lidhur me këtë çështje penale.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.64/22 të datës 28.02.2022, kundër të akuzuarit R. K. për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 par. 1 të KPRK-së.

Meqenëse i akuzuari i është shmangur thirrjeve të gjykatës dhe prezenca e tij ka qenë e pa mundur të sigurohet, me datë 22.08.2023 gjykata, ka lëshuar urdhërarrest për të akuzuarin R. K. P.nr. 109/22 përmes Policisë së Kosovës-Stacionit Policor Mitrovicë-Veriu.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 08.03.2024, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Muharrem Prekazi, i akuzuari R. K. i cili është sjellur në gjykatë në bazë të urdhërarrestit, si dhe i dëmtuari N. K..

Prokurori i Shtetit para leximit të aktakuzës fillimisht ka bërë ndryshimin e gjendjes faktike të përshkruar si në dispozitiv të saj, ashtu që në rreshtin e 4 fjala e dytë “elektrike” duhet të zëvendësohet me fjalinë “fshesë – karrocë për pastrimin e parketit dhe keramikës”, që nënkupton se fshihet fjala elektrike dhe zëvendësohet me fjalën karrocë, ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës ka mbetur e pandryshuar.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, të akuzuarit i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, ashtu që në këtë seancë i akuzuari lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se e pranon fajësinë në tërësi sipas aktakuzës. Tutje ka shtuar se është penduar thellë për rastin që ka ndodhur, ka gabuar shumë dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë më veprime të tilla, nuk do të ndodhin më kurrë veprime të tilla nga ana e tij dhe i ka kërkuar falje sinqerisht palës së dëmtuar.

Prokurori i Shtetit Muharrem Prekazi lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se, i propozon gjykatës që të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, meqenëse i akuzuari këtë deklaram e ka dhënë pas njoftimit nga ana e gjykatës për pasojat dhe

benefitet e pranimit të fajësisë dhe meqenëse si i tillë është në përputhje me provat dhe shkresat e kësaj çështje penale. Nga këto arsye konform nenit 242 të KPP-së, ka propozuar që i njëjti të aprovohet në tërësi. Po ashtu ka propozuar që më rastin e caktimit të lartësisë dhe llojit të dënimit të merren parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me Kodin Penal.

I dëmtuari N. K., lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se, e mbështet në tërësi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, e pranon kërkim faljen nga ana e tij, duke theksuar se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale, nuk kërkon kompensim dëmi – nuk kërkoj që të i kthehet dëmi, pra nuk paraqet kërkesë pasurore juridike ndaj të akuzuarit.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit mbështetet në provat të cilat i disponon kjo gjykatë si: Raporti fillestar i incidentit me numër 2021:-BC-1204 i datës 14.12.2021, procesverbali i marrjes në pyetje të të dëmtuarit N. K., i datës 14.12.2021, procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin-tani të akuzuarin R. K., i datës 27.12.2021, foto-dokumentacioni nga shkresat e lëndës, video incizimet nga CD e bashkangjitur, si dhe shkresat tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të këtyre provave dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në mënyrë vullnetare, se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke e njoftuar të akuzuarin se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, nga këto arsye gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe nga provat e cekura si më lartë, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari R. K. ka kryer veprën penale: Vjedhja nga neni 313 par. 1 të KPRK-së, e për të cilën vepër është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Gjykata, si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale nga i akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar, keqardhjen e shprehur dhe pendimin e thellë për veprën e kryer duke i kërkuar falje para gjykatës të dëmtuarit, si dhe premtimin e të akuzuarit se në të ardhmen nuk do të përsërisë më veprime të tilla. Ndërsa, si rrethanë rënduese gjeti faktin se i akuzuari e ka penguar rrjedhën e procedurës penale duke iu shmangur thirrjeve të gjykatës dhe prezenca e tij në procedurë është siguruar vetëm në bazë të urdhër-arrestit.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit. Po ashtu gjykata vlerëson se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 38 të KPRK-së, që të parandalojë kryesin

nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor gjykata e mori në kuptim të nenit 449 par.2 nën par 2.6 dhe nenit 452 par.1 të KPP-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 nën. par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 460 të KPP-së, kjo pasi që i dëmtuari në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se heqë dorë nga kjo e drejtë.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni penal**  
**P.nr.109/22, datë: 19.03.2024**

**Zyrtari ligjor**  
Besart Mustafa

**Gjyqtarja e vetme gjyquese**  
Benita Berisha

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate.